

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Hektor Çiftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Besoj se është neglizhencë, që nuk janë pajisur antarët e këshillit me një baxh, kështu që kryetar sëbashku me sekretarin që do zgjidhni sot na pajisni me ndonjë gjë që të kemi document për të hyrë ktu brenda. Sepse dhe kur hyjmë për punët e bashkisë ato që sna njohin me të drejtë thonë bëj telefon. Ka një përgjegjësi te sekretaria, te neglizhenca për të pajisur antarët e këshillit.

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kryetar kam diçka unë, para se të fillojnë diskutimet doja të pyesja për diçka mundem? E kam me Kryetarin e Bashkisë përpara se të miratojmë rendin e ditës. Lutfi ma jep lejen të flas apo jo? Ka të bëjë me rendin e ditës ndërkohë që presim mos humbim kohë. Kisha një shqetsim

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar këshilltarë, I nderuar kryetar, të nderuar pjesëmarrës mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së muajit dhjetor, mbledhja e fundit të vitit 2025. Është një mbledhje nga më të rëndësishmet e vitit për arsye sepse miratohet buxheti I bashkisë. Ftoj Enerjetën të bëj apelin.

Enerieta Ferra – Zv. Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin. Në sallë janë 43 Antarë të Këshillit Bashkiak.

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Nisur nga shqetësimi që kam marrë nga banorët e Elbasanit, doja një informacion nëse ka mundësi nga personeli I bashkisë, ka të bëjë me shpërblimet që ata pretendojnë që ka akorduar qeveriapër personat me aftësi të kufizuara me invalid të lindur. Janë në dijeni të një vendimi të qeverisë, një shpërblim në fund të vitit 15.000 lekë të reja, I cili nuk është pasqyruar në asnjë vendim të këshillit

bashkiak.Në qoftë se keni mundësi të jepni një informacion shumë të shpejtë, unë do kërkoja që të futet në rend të ditës.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqenëse akoma nuk ka material të gatshëm po diskutojmë ta bëjmë me vendim qarkullues.

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje, është e dyta herë që ju kërkoj sepse është depozituar një material për interpelancë dt 17.11.25 pranë bashkisë.Duhet të ishte që në mbledhjen e kaluar por nuk është as në këtë mbledhje tek të ndryshmet.Një përgjigje mund ta kem kur do bëhet?Zoti Luti ka thënë që duhet të presim përgjigjen nga kryetari kështu që kryetari jeni ju dhe po ju pyes ju.Duhet të ishte që në mbledhjen e kaluar, e kërkoja dhe nuk ishte, ja thashë edhe tek komisionet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Sipas rregullave, kërkesa është brenda afateve, duhet të përgjigjesh brenda 7 ditëve por tek neni 130 pika 6 me kërkesë të kryetarit përgjigja mund ti jepet dhe një muaj me vonesë dmth në mbledhjen pasardhëse, gjë që e kemi diskutuar dhe problem tjetër është se kjo duhet të futet në rend dite nga sekretarjati, një pikë e veçantë.Mbledhjen e ardhshme e ke në mënyrë taksative.Faleminderit!

Kalojmë tek pika e parë për miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës

1.Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 1 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (E.Murataj)

V.A (A.Meçja;A.Murati)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi I proçesverbalit të muajit nëntor datë 27.11.2025

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro,- kundër, 5- abstënim, miraton sa më sipër.

V.A (M.Kaçuli;A.Marku;A.Meçja;E.Murataj;A.Murati)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I bashkisë për muajin nëntor 2025

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (E.Murataj;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3.1 e rendit të ditës

3.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për muajin nëntor 2025

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro,- kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (E.Murataj;E.Muzhaqi;D.Madhi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Mbi emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në bazë të ligjit 139/2015 dhe të rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak, kryetari i këshillit ka të drejtë të propozojë sekretarin e këshillit dhe këshilli e miraton. Është menduar Z. Elsid Zyma të miratohet nga këshilli për sekretar. Është banor i bashkisë Elbasan, i cili është një kusht, me arsim të lartë, me një eksperiencë pune mbi 5 vjet që e kërkon rregullorja dhe i ka. Ka punuar tek ujësjellësi, tek Enti Banesave, vetëm kohët e fundit ka qenë 4 vjet drejtues i Njësisë Administrative. Unë besoj se i përmbush të gjitha kushtet dhe mundësitë, e njoh për njeri korrekt, i cili do të jetë një pikë kontakti midis këshillit dhe bashkisë dhe dua ta hedhim në votim. Kishte njeri ndonjë gjë në lidhje me rastin konkret?

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro,- kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (M. Kaçuli; A. Kana; D. Madhi; E. Murataj; E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Elsid mund të afrohesh

Elsid Zyma – Sekretar i Këshillit Bashkiak Elbasan

I nderuar kryetar faleminderit të gjithë antarëve të këshillit. Për mua si qytetar Elbasanas është privilegj të jem në këtë detyrë dhe premtoj se do të kem angazhimin maksimal për të bërë këtë punë. Faleminderit!

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5. Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026 si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Faleminderit kryetar I këshillit, të nderuar antarë dhe qytetarë që na ndiqni online. Pas një procesi të gjatë dëgjësash publike që u pasua me një punë intensive me strukturat e bashkisë, kam kënaqësinë të prezantoj sot para jush buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026. Përpara se të filloj dua të cilësoj se janë bërë takimet fizike në 18 Njësitë Administrative si dhe me grupet e interesit. Në qytet janë takuar mbi 900 veta, në fshat 609 veta, online janë përgjigjur kërkesës në faqen tonë ose janë interesuar dhe kemi marrë feedback për 512 qytetarë ku në total janë mbi 2.000 qytetarë të angazhuar në buxhetimin me pjesëmarrje, ose 1.72% e popullsisë së Bashkisë së Elbasanit. Duke garantuar se kemi dëgjuar me vëmendje kërkesat e qytetarëve por kemi pritur dhe kërkesat e antarëve të këshillit apo edhe kërkesat që mund të kenë pasur antarët e këshillit për ndryshime të mundëshme në buxhet sot paraqesim prioritetet për vitin 2026 ku është një buxhet realist dhe të orjentuar qartë drejt qytetarit. Krahasimisht me vitin e mëparshëm, pra me vitin 2025 me vitit aktual buxhetor që ne jemi kemi një rritje të Buxhetit me 6% i cili tashmë ka arritur në 4 miliard e 13 milion lekë duke na krijuar mundësinë të konsolidojmë më tej përmirësimin e shërbimeve publike, mbështetjen e zhvillimit ekonomik e social të zonave urbane dhe rurale duke balancuar nevojat e përditshme të komunitetit me investimet që na çojnë drejt vizionit tonë drejt zhvillimit të qytetit dhe zonave rurale më të mira. Investimet e reja dhe të planifikuara për vitin 2026 programohen në rreth 612 milion lekë çka përbën rritje me 82 milion

krahasuar me vetëm një vit më parë. Sakaq, investimet në progres (pra projekte të nisura) me disa vite financim parashikojnë edhe rreth 241 milion lekë të tjera çka e çon angazhimin total financiar të Bashkisë Elbasan për investimet në rreth 853 milion lekë. Buxheti 2026 ka prioritet kryesor shërbimet publike vendore. Një qytet më i pastër, më i ndriçuar dhe më i sigurt do të mundësohet përmes investimeve të programuara për pastrimin, ndriçimin publik, mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, varrezave dhe hapësirave të gjelbra. I kemi kushtuar vëmendje arsimit dhe përkujdesjes sociale duke garantuar funksionimin normal të çerdheve, kopshteve dhe shkollave, mbështetjen e stafit arsimor, si dhe investime në infrastrukturën arsimore. Buxheti mbështet fuqishëm shtresat në nevojë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet vulnerabël, duke garantuar një qasje më humane dhe më gjithëpërfshirëse të shërbimeve sociale. Buxheti i vitit 2026 mbështet kulturën, sportin dhe aktivitetet rinore, si elementë thelbësorë për një qytet me jetë aktive dhe identitet të fortë. Financimi i aktiviteteve kulturore, institucioneve artistike dhe sporteve synon jo vetëm argëtimin, por edhe promovimin e vlerave dhe talenteve vendore. Në këtë buxhet janë parashikuar fonde të posaçme për mbrojtjen civile, shërbimin zjarrfikës dhe emergjencat, si dhe fonde rezervë dhe kontigjence, për të garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj situatave të paparashikuara, në shërbim të sigurisë së qytetarëve. Brënda këtij buxheti janë një seri investimesh të cilat mi lejon ti cilsoj dhe dhe të kërkoj dhe miratimin tuaj më von për vazhdimin e tyre në vitin 2026. Më lejon që të listoj disa nga investimet që kemi bërë gjatë vitit 2025 ku përmendim rikonstruksionin I rrugës kryezjarr njësia administrative Shirgjan ku ka filluar këtë vit dhe vazhdon dhe vitin tjetër si investim dhe si pjesë e punës, rikonstruksionin I godinës ekzistuese së shkollës Dhaskal Todri, të shkollës Naim Frashëri, të shkollës së Shushicës, rikonstruksionin i sallës së brëndëshme të shkollës Onufri, rikonstruksionin e objekteve arsimore, rikonstruksionin I shesheve të pallateve 583 dhe 584 në lagjen Visarjon Xhuvani, ndërtimi I këmbëve të urave në perroiin Lugaj në Labinot Katund njësia Adm. Labinot Mal, ndërtimi I këmbëve të urave tip beli në fshatin Matrej, Papërr Sollak dhe Muriqan si dhe urave beli në këto fshatra, rikonstruksionin I tregut të fruta perimeve ose sic njihet ndryshe I tregut të vogël në qytet afër stadjumit, mbrojtja lagjeve të Noneve nga përroi I lumit Gostim fshati Polis Valë Njësia Adm Shushicë, ndërtimi I shkollës 9-vjecare Jonuz Carciu Tregan, ndërtimi I urës mbi perroiin e llixhës në fshatin Jagodinë, ura në fshatin Balta e Gaxhes lagjia

Katund I vjetër Shushicë,muri pritës për shpëtimin e disa shpijave në lagjen 5 maji në rrugën Hysen Ali Kopili,restaurimi I muzeut Etnografik,rindërtimi I ambjenteve të brëndëshme tek sporti I vjetër të dhomave të zhveshjes por edhe I fushës të terrenit të madh sportiv me kushtet më të mira të Federatës Shqiptare të futbollit, prishja e objektit ekzistues dhe ndërtimi I objektit 2 katësh cerdhja nr 5 cerdhja e re e qytetit të Elbasanit,projektimi për pellgun ujëmbledhës të zaranikës ku në project kemi përfshirë një plan të përfunduar për reabilitimin e komplet pellgut ujqor të shushicës bashke me përrejtë e saj malor,restaurimi I shtëpisë muze Aleksandër Xhuvani,rikonstruksioni I cerdhes nr 2,rikonstruksioni I shkollës 9-vjecare Fadil Gurmani,rivitalizimi urban I rotondave tek kryqëzimi luleve,1 maji,postës dhe rotondës së Bashkisë, Rivitalizimi urban i shesheve publike të pallateve 580 në lagjen 5 maji I cili është në proces dhe vazhdon dhe vitin tjetër,veshja me beton e kanaleve kulluese 1 dhe 2 të njësive tona administrative,asflatimi I rrugës së xhamisë ne fshatin Vreshatj njesia Adm.shushicë.kemi vazhduar me një sërë projektesh të tjera ku do të vazhdojmë me një sërë projektesh që kanë ardhur dhe në bashkëpunim dhe me fondin shqiptar të zhvillimit ku janë një sërë rrugësh të asflatura,kemi rrugët të cilat janë bërë me fondin shqiptar të zhvillimit në një sërë fshatrash në rrugët e Labinotit Fushë dhe në rrugët e një serë njesive tona adm.Do të cilsoja dhe një sërë investimesh që janë parashikuar në buxhetin tonë ku një pjesë e tyre parashikohen të jenë me fondin tonë por kemi dhe një listë investimesh të cilat janë me fondin shqiptar të zhvillimit apo dhe institucione të tjera të shtetit shqiptar me bashkëfinacine.Kemi pasur dhe jemi përpjekur që në këtë buxhet të kemi një balancim ndërmjet investimeve ne fshat dhe investimeve në qytet.tek minvestimet në fshat doja të cilësoja disa nga investimet kryesore të cilat parashikohen të kemi në këtë vit finaciar janë gati 3 milion euro ose 300 milion lekë lekë për sistemim/asfaltimin e rrugëve rurale,me një shtresë mikser ku parashikohet, rruga Salla e Reformës në fshatin Hajdaran; rruga e fshatit Polis i Vogël; Lagja e Sinanëve dhe Xhakallarëve në Mlize; rruga e shkollës së mesme në Kuqan; rruga e fshatit Kështjellë; rruga e lagjes Gorrice; rruga e brendshme Llixha Hidraj në Kyçyk; rruga e fshatit Petresh; rruga Paper-Paper Dambe; rruga e shkollës dhe rruga e nënstacionit Vidhas; rruga e fshatit Dopaj; rruga e fshatit Samur; rruga Griqan-Labinot Katund; rruga e varrezave, Labinot Katund; rruga Ura e Shqaut - Shkolla 8 vjeçare; rruga Tudan-Kryezjarr; rruga Shelcan-Trepshenist; rruga e pallateve dhe lagja Tola në Shushicë; rruga e fshatit Bathës,gjithashtu kemi dhe

përmisimin në Labinot Katund përmisimin e shtresave asflatike. Në qytet vazhdojmë me një serë investimesh për sa i përket lagjeve të brëndëshme të qytetit kemi një sërë investimesh të cilat na vinë gjate ktij buxheti ku përmendim Rehabilitim I shesheve te pallateve 587, 588, 688/1 në lagje “Haxhias”.

Rehabilitim I shesheve te pallateve 586 dhe rrugës “Ramazan Sina” në lagje “Haxhias”.

Rehabilitim I shesheve te pallateve 645/1, 645/2, 645/3 në lagje “Vullnetari”.

Rehabilitim I shesheve te pallateve 39, 42/4, 43, 44, 40 në lagje “Luigj Gurakuqi”.

Rehabilitim I shesheve te pallateve 496, 496/1, 496/2, 496/3, 496/4 në lagje “Visarion Xhuvani”.

Rehabilitim I shesheve te pallateve 82/1, 82/2 dhe 83/1 në lagje “Çlirimi”.
Sistemim I rrugës “Petraq Popa” dhe sheshit para rajoni administrative Nr.2 ne lagje “Brigada 17 Sulmuese”.

Sistemim I rrugës “Lirak Dodbiba” dhe “Gani Daiu” në lagje “11 Nëntori”

Sistemim I rrugës i Rrugës ‘Qamil Xhaja’ në lagje “Syrja Dylgjeri”

Rehabilitim I shesheve te pallateve 107/1, 107/4 në lagje “Syrja Dylgjeri”

Në total vlera e parashikuar e investimit 140 000 000 lekë.

Gjithashtu kemi futur për rikonstruksionin e urave dhe veprave të artit në rrugët rurale janë planifikuar 25,000,000 lekë, për ndërtimin e tregut të ri bujqësor markata qendrore e qytetit pasi përfunduar rikonstruksionin e markatës së vogël të qytetit tashme I ka ardhur koha që në bashkëpunim me ministrin e bujqësisë të fillojmë me një plan dy vjecar rikonstruksionin e markatës kryesore të qytetit me një project të plotë me ministrin e bujqësisë. Në sektorin e arsimit dhe objekteve sociale janë planifikuar investime mbi 56,189,424 lekë për rikonstruksion shkollash, zgjerime godinash dhe përmirësim kushtesh, si dhe 32,588,000 lekë për rikonstruksionin e Qendrës Sociale në Balashë, k uke qendra balashe kërkohet rivitalizim kemi një project ë plotë pa mobilimin dhe për mobilimin do të futemi në një moment tjetër në këshillin bashkiak ku ka ardhur momenti që te rikonstruktohet qendra balashe totalisht pas disa rikonstruksioneve të pjeshme me ndihmat e organizatave joqeveritare, do të bëhet dhe rikonstruksioni I qendrës ditore të mikpritjes ku marin ushqim falas shtresat në nevojë gjithashtu dhe qendrës ditore për trajtimin e fëmijëve me nevoja të vecanta. Në katin e parë të kësaj godine do të krijojm ambjente për hapjen e cerdhes nr 6 ku do të përfshimë një pjesë të lagjes Skënderbej dhe një pjesë e lagjes Shënkoll. Investime direkte në objekte arsimore

për vitin 2026: 24 milionë lekë; Investime shumëvjeçare në arsim: mbi 56 milionë lekë vetëm për vitin 2026. Shkolla 9-vjeçare "Fadil Gurmani", Shkolla 9-vjeçare "Naim Frashëri", Shkolla Shushicë, Shkolla "Dhaskal Todri". vazhdojmë me një sër investimesh të tjera të parashikuara për vitin 2026 ku një fond të rëndësishëm e kemi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm janë parashikuar 39,300,000 lekë për projekte energjie të rinovueshme, automjete elektrike dhe sisteme fotovoltaike, si dhe Buxheti 2026 i kushton vëmendje të veçantë mjedisit: Ndërtimi i Qendrës së Kompostimit, Vlera totale: 35 milionë lekë. Sisteme fotovoltaike në shkolla – 13 milionë lekë ku kemi qënë një bashki pilot për sistemin voltaik nëpër shkolla ku kemi implementuar një projekt me sukses në 7 shkolla dhe skemi paguar energji elektrike, modeli që ne duhet të edukojmë femijet dhe qytetarët. Vendosija e një sistemi të ri për kamerat termale për zbulimin e zjarreve në pyje ku janë parashikuar dhe një sër investimesh me vlerën 25 milion lekë të rinjë për pyjet dhe kullotat dhe luften biologjike sidomos në zonën e Gjinarit. Prioritet për sa i përket turizmit, patjetër që këto investime do të përfshin dhe investime të tjera në shkolla modele të reja që ne duhet të fusim nëpër shkolla sidomos në shkollat e mesme me një projekt pilot për serat hidroponike por dhe një mbështetje për programin art dhe zeje në shkollat tona. Në fakt këto investime janë një hap konkret për një bashki më të gjelbër më efikase më energjike. Gjithashtu, për kulturën dhe trashëgiminë kulturore janë planifikuar 18.3 milion lekë, ndërsa për teknologjinë, digjitalizimin dhe pajisjet mbështetëse të administratës janë parashikuar mbi 14 milion lekë." Për vitin 2026 kemi të parashikuar në bashkëpunim dhe me ministrin e kulturës ku në thirrjet që ato do të hapin kemi prioritetin tonë me një vlerë prej 6.9 milion lekësh për bashkëfinancim për teatrin skampa, ndërko muzehu Aleksandër Xhuvani dhe muziu i jonormalës vitin tjetër do të vazhdojmë me arredimin dhe digjitalizimin e bibliotekave të Elbasan Qemal Baholli është një nga prioritet tona kryesore në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës me një projekt me të cilin po hartohet dhe do të financohet nga ministrai e kulturës për një ambjent të përshtatshëm për qytetin dhe një bibliotekë për të ruajtur vlerat që ka biblioteka jonë për ta bërë atë sa më pranë qytetarëve dhe rinisë. Gjithashtu kemi parashikuar projekte për rininë me një vlerë rreth 5 milion lekë për vitin 2026. Shërbimet sociale dhe përfshirjet sociale buxheti I vitit 2026 që në thelb të tij kemi rikonstrukcionin e qendrës sociale Balashe projekti fit për jetën një projekt me bashkëfinancim me ministrin dhe përmisimin e infrastrukturës sportive dhe hapsirave publike. qëllimi ynë në Elbasan është që të jetë një qytet sa më solidor që askush të mos mbetet mbas dhe ku shërbimet sociale janë të aksesueshme dhe dinjitoze për të gjithë qytetarët. kemi dhe një investim ku do të rregullojmë lulishten që ka ngelur para bashkisë tek rrethrotullimi 1 Majit ose tek pas monumentit të arsimtarëve. Lista e prioriteteve që kemi cuar dhe do të cojmë për fondin shqiptar të zhvillimit është asflatimi i rrugës Tajar Tetova ku shumë

shpejt fillojnë kanalizimet e ujrave të zeza dhe më pas vazhdojmë me sistemimin dhe asfaltimin e rrugës qamil Lopari, rikonstruksioni I rrugës Xibrak-qarret, sistemimi I rrugës lagjia Skënderbej, sistemi I një blloku të madh gati 250 banesa në fillimin e rrugës Iljaz Kosova lagjia skënderbej në krahun e majtë të cilën e kemi me fondin shqiptar të zhvillimit , rikonstruksioni I rrugës kisha e shijonit, dopaj ku një pjesë është parashikuar në buxhetin tonë dhe pjesa tjetër prej rreth 8 km është parashikuar si prioritet tek fondin shqiptar I zhvillimit, rikonstruksioni I rrugës gjinar-zavalinë, dhe përfundimi I rrugës shtërmën-bujaras. Me ministrin e bujqësisë është ndërtimi I argjinaturës, është tregu kryesor ose tregu I qytetit ndërtimi I argjinaturës mbrojtëse nga lumi Shkumbin në lagjen Shënkoll, ndërtimi I argjinaturës mbrojtëse në lumin Shkumbin në segmentin Bujqas jagodin 3.5 km linear, është dhe një project ku duam të përfundojmë dhe argjinaturën e lumit Shkumbin ku vit pas viti kemi bërë investime të ndryshme. ndërko nga ministrai e mbrojtjes prioriteti jonë kryesor do të mbetet rikonstruksioni I digës në fshatin bixëllenjë njesia adm Funar. Tek ministria e turizmit kulturës prioritet kemi rikonstruksioni I teatrit Skampa dhe rikonstrukioni I bibliotekes publike Qemal Baholli. Të nderuar këshilltarë kjo është një pjesë e prioriteteve ne jemi të hapur për diskutime dhe vazhdimin e diskutimit. Faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit kryetar, fjala për Znj. Doris, në emër të komisionit të ekonomisë.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Kryetari ishte mjaftueshëm shterues për prezantimin në letër të buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026. Unë do të thoja vetëm 2 fjalë dhe në fakt do lija kolegët që të diskutonin për aq sa munden lirisht. Mënyra se si është planifikuar, prapë e them në letër, buxheti I vitit 2026 që është rreth 4.1 miliard lekë, është ndarë në të ardhura dhe shpenzime të cilat duken të balancuara. Përsa I përket rritjes së të ardhurave e cila shkon nga 6-23% për vitin 2026, ky parashikim vjen si pasojë e faktit që edhe në paketën fiskale që u miratua nga Këshilli Bashkiak muajin e kaluar. Ka një rritje të konsiderueshme të tarifave që shkojnë nga 20-25%, atyre kryesoreve që janë tarifa gjelbërim pastrim dhe më pas edhe të taksave vendore qofshin ato të ndara apo ato me origjinë tatimore. Bashkia Elbasan sigurisht që për të ardhurat e taksave me origjinë tatimore ka edhe kontratat përkatëse me drejtoritë vendore të cilat shërbejnë si vjelëse kryesore e më pas kalojnë përqindjen në Bashkinë Elbasan. Përsa I përket pjesës së shpenzimeve, nëse

I shikojmë të detajuara, drejtoritë të cilat shpenzojnë më shumë janë Drejtoria e Shërbimeve Publike Rurale dhe Urbane. Akoma vërejmë që rritjet në shpenzime përsa I përket pjesës së mbrojtjes sociale, arsimit janë shumë të ulta dhe shkojnë nga 1-4%. Përsa I përket pjesës së investimeve dua të theksoj që jo të gjitha prioritetet të nxjerra nga dëgjuesat publike janë të përfshira këtu sepse vërej edhe në një analizë paralele, me realizimin e buxhetit të 2025 ka shumë mangësi dhe sigurisht që ka edhe investime të cilat duket sikur janë të këtij viti por në fakt janë investime të mbartura nga vitet paraardhëse. Unë nuk dua për momentin ti jap ngjyrim politik kesaj parantezës që bëra. Nëse juve do më lejoni desha të ftoj kolegët në diskutim tani për zëra të veçantë përsa I përket pjesës së shpenzimeve dhe të investimeve. Dua të jem asnjansë në këtë moment. Në emër të komisionit kjo është paranteza që unë bëj për buxhetin.

Hektor Çiftja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Besoj që parashtrimi I buxhetit për vitin që vjen nga Kryetari I Bashkisë ishte vërtet shterues. Buxheti 2026 I pasqyruar është padiskutim një buxhet realist, i përgjegjshëm, I orientuar qartë drejt qytetarit. Kur themi realist duhet të kemi parasysh sat ë ardhura kemi, sa mundësi kemi, dhe sa kemi dëgjuar qytetarët. Natyrisht këtu mund të kemi kritika pa fund, nëse janë dëgjuar dhe plotësuar të gjitha. Një nga gjërat që vihet re është që ato pika që janë realizuar, janë realizuar dhe nuk kanë nevojë për raporte investimesh siç u përmend psh arsimit dhe shërbimet sociale, të cilat janë investim për të ardhmen, ato janë fonde të parashikuara që garantojnë funksionimin normal të çerdheve, garantojnë kopshtet dhe shkollat, garantojnë mbështetjen e stafit mësimor si dhe investime në infrastrukturën arsimore. Po ashtu ky është një buxhet që mbështet fuqishëm edhe shtresat në nevojë, familjet e pafavorizuara, të moshuara personat me aftësi të kufizuara aq sa e lejon ligji. Mbështetja për kto grupet vulnerable nuk është vetëm e drejtpërdrejtë nëpërmjet dhënie fondësh por është edhe e krijimit të lehtësirave dhe investimet nëpër rrugët rurale janë lehtësira për këto shtresa në nevojë. Padiskutim që bëhet fjalë për një shumë prej 4 miliard e 13 milion lekësh që garanton një funksionim normal të institucionit, rrit cilësinë e shërbimeve publike, mbështet zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit dhe Njësi Administrative. Bëhet fjalë për një buxhet që garanton një administratë funksionale në shërbim të qytetarit, një buxhet të dedikuar administrimit, menaxhimit të aparatit bashkiak me qëllim që shërbimet për qytetarët të jenë sa më efikase më transparente dhe më të shpejta. Ky

financim siguron dhe vazhdimësinë e punës së administratës, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe mirmbajtjen e infrastrukturës institucionale. Shërbimet publike më cilësore në çdo lagje dhe në çdo fshat I parashikon pikërisht ky buxhet I 2026-ës me theks të veçantë në shërbimet publike vendore përfshirë pastrimin, ndriçimin public, mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, varrezave dhe hapësirave të gjelbërta. Këto fonde synojnë një qytet shumë më të pastër, më të ndriçuar e më të sigurtë sin ë zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Ndjesë që po përmbledh fjalën e kryetarit por sepse e besoj atë fjalë sepse është fjala e duhur. Pa diskutim që buxheti I 2026-ës mbështet kulturën, sportin dhe jetën aktive në komunitet që janë element kryesor për një qytet me jëtë aktive dhe me identitet të fortë. Financimi I aktiviteteve kulturore, institucioneve artisitike, sporteve synon jo vetëm argëtimin por dhe promovimin e vlerave dhe talenteve vendore. Ky buxhet është I përkushtuar për sigurinë dhe për emergjencat dhe mbrojtjen civile që kryetari e përmendi shumë qartë dhe dokumentat që kemi e kanë përmendur shumë qartë. Në këtë buxhet janë parashikuar fonde të posaçme për mbrojtjen civile, shërbimin zjarrfikës, emergjencat, si dhe fonde rezervë dhe kontigjence për të garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj situatave të paparashikuara në shërbim të qytetarëve. Pa diskutim që bëhet fjalë për investime që ndërtojnë të ardhmen, që I paraprijnë të ardhmes. Ne shpresojmë që në të ardhmen mos të kemi të njëjtin buxhet. Kemi një tabelë aty, është tabela nr 5 që janë investimet kapitale të cilat përfaqësojnë një angazhim të drejtpërdrejtë për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Elbasan dhe theksoj fjalën qëndrim. Këto investime synojnë përmirsim e infrastrukturës, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik dhe social. Për mbyllje në tërësi buxheti I 2026-ës I Bashkisë Elbasan është I balancuar, social, zhvëllimor dhe e vendos në qendër qytetarin. Garanton stabilitet financiar dhe kjo është shumë e rëndësishme dhe e kam thënë dhe në mbledhjen e kaluar ndërton themele të forta për një të ardhme të qytetit. Ky buxhet nuk është thjesht një dokument financiar, ta themi troç çdo buxhet sidomos ky buxhet është kontratë besimi me qytetarët e Elbasanit. Unë ftoj që ta votojmë.

Bianka Çopja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përsëritet. Këtë buxhet nuk do ta quaja fare një buxhet zhvillimi por një faturë e përgatitur për qytetarët për dështimet e Bashkisë Elbasan. Sepse e fillojmë që nga paketa fiskale me rritje taksash për të mbuluar paaftësinë. Familjet paguajnë më

shumë, biznesi I vogël paguan më shumë, fshati paguan më shumë, ndërsa ju vazhdoni të paguani vetëm për veten tuaj. Kjo më saktë nuk është një paaftësi tenike, por është një mashttrim financiar sepse në këtë buxhet shikohen miliona lekë për paga, zyra, shpenzime operative dhe qindarka për lagjet, fshatrat dhe njerëzit në nevojë. Nuk kam parë në këtë buxhet të 2026-ës një projekt madhor që ta ndryshojë Elbasanin. Vetëm copëza investimesh sa për propagandë edhe dukje në faqet tuaja të rrjeteve sociale. Buxheti me pjesëmarrje është një gënjeshtër publike sepse mbi të gjitha është turp që vazhdoni të talleni me qytetarët për prioritetet që keni marrë në këtë buxhetim. Asnjë nga këto prioritete, mos thënë një pjesë shumë shumë e vogël është marrë parasysht. Nuk ka patur as diskutim real dhe as dëgjesa reale dhe reflektim mbi propozimet e qytetarëve të Elbasanit. Për kulturën, kultura do të thojë që është zero. Elbasani që është një qytet kulture, historie dhe identiteti duhet të ketë kaq pak kulturë dhe buxhet për kulturën dhe për rininë. Mbi të gjitha është e drejtë që kultura këtu tek ne trajtohet si dekor e jo si prioritet. Flisni mbi të gjitha për një arritje në buxhetin tuaj dhe rritje, jo nuk ka asnjë rritje në këtë buxhet. Kemi shërbime sociale minimale, mbështetje për të rinjtë vetëm në letra. Prioriteti real i qytetarëve nuk është askund. Ah po, po bëni rrugë, sheshe, objekte pallatesh me bashkëfinancim, projekte që nuk janë meritë e menaxhimit tuaj por po i mbani peng ato që të rinovohen në vitin aktual. Dëgjova nga ju që është rinovuar kontrata e pastrimit dhe nga informacionet e marra është për të ardhur keq që ato puntorë trajtohen si skllevër edhe pse duke justifikuar faktin që kanë vetëm 4 orë punë dhe kompania private që ju keni rinovuar kontratën është gjobitur nga inspektorati i punës në lidhje me kontratat e parregullta që ka. Është detyra juaj që mbi të gjitha të ushtroni veprimtarinë dhe ata të bëjnë kontratat e duhura për këta puntorë. Për rrugët është keq të flasësh, janë minimale. Do të thojë përsëri tek kultura mesa di në Bashkinë Elbasan ka ardhur një projekt të një koncerti që bëhet çdo vit në Elbasan dhe nuk e shikoj në buxhetin e vitit 2026. Është vlerë shumë e vogël, ai buxhet është minimalist, nuk mund të jetë 5 milion lekë por duhet të jetë 15-20 milion lekë. Kjo nuk është normale sepse po flasim për Elbasanin që është djep kulture, nëse duam të flasim siç është për të folur. E jo për grimca të vogla. Uroj që qytetarët e Elbasanit ta kuptojnë që kjo është një farsë dhe një paaftësi e Bashkisë tonë të Elbasanit. Faleminderit.

Imelda Sejdini-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Faktikisht unë nuk jam aspak dakort me parafolësen me Znj.Çopja, për të gjitha ato që tha në lidhje me buxhetin.Bashkia e Elbasanit e ka treguar ndër vite që bën buxhete të mira siç e tha dhe Znj.Madhi që në letër të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet janë të balancuara por këto realisht nuk janë vetëm në letër sepse ne nga viti I kaluar në këtë buxhet kemi vetëm 5 % të të ardhurave të trashëguara gjë që do të thotë që të gjitha ato që janë planifikuar janë realizuar në kohë dhe në afat dhe për këtë vit të gjitha ato që janë planifikuar në të gjitha drejtimeQoftë të ardhurat që vijnë nga granti I qeverisë, qoftë të ardhurat që vijnë nga burimet e veta të bashkisë dhe patjetër që në këtë buxhet janë reflektuar në shpenzime në shërbim të qytetarëve duke adresuar të gjitha prioritetet që dalin nga buxhetimi me pjesëmarrje reflektohen në programe jo vetëm 1 vjeçare por edhe në programe që shkojnë përtej afatit 1 vjeçar.Këto investime pjesërisht patjetër që do të parashikohen në buxhetin e këtij viti.Pra nuk janë investime që fshihen në këtë buxhet por janë investime që copëzohen sipas zërave që I takojnë çdo viti.Ky buxhet unë mendoj se është tërësisht I balancuar si në të ardhura ashtu edhe në shpenzime dhe I reflekton më së miri të gjitha ato nevoja që kanë qytetarët për investime në kulturë, në arsim, në sport.Prioritet ju është dhënë këtyre fushave të cilat kanë më shumë nevojë dhe patjetër që një pjesë e mirë e nevojave janë mbuluar dhe në buxhetet e viteve të mëparshme.Pra prioritet do ti kushtohet atyre investimeve të cilave tashmë I ka ardhur rradha për tu bërë.Dihet që të ardhurat janë të kufizuara por nevojat janë të pakufizuara prandaj jo çdo gjë mund të përmbushet në buxhetin e një viti ndaj unë do ti ftoja të gjithë këshilltarët ta votojnë këtë buxhet pasi mendoj që është një buxhet shumë real, konkretisht I realizueshëm në të gjitha zërat që ai përmban.Faleminderit.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Këtu u thanë shumë të pavërteta, qëndron në letër.Në 2023 kjo bashki ka thënë që Elbasani ka 216.900 banorë.Në 2022 kemi patur 215.000 banorë, në 2024 208.480 banorë.Nuk kan marrë mundimin as ta korrektojnë këtë vit, falë Këshillit të Qarkut kam zbuluar shifrën dje që ishte diku te 205.892 pra 2588 banorë më pak.Çfarë do të thotë kjo?Sepse nuk është as në letër.Mjafton të kalojmë tek rritjet të cilat vijnë si rezultat I paketës fiskale.Taksat e ndara arrijnë 13% më shumë në krahasim me vitin paraardhës, përkthyer ndryshe 240 milion lekë.Vijojmë me 12% te taksat

vendore të cilat arrijnë një shumë prej 12 % prapë rritje. Tarifat 44%, kjo do të thotë që çdo banorë i Bashkisë Elbasan vetëm për tarifën do të paguajë në vit 11.000 lekë të vjetra më shumë, vetëm për tarifën. Ndërkohë që po të vijojmë tek pjesa e rritjeve për sektorë të tjerë siç është ndikimi në infrastrukturë, kemi shumë pak sepse gjithçka është përfituar më përpara do të kthehet në leje ndërtimi sot. Sepse parqet fotovoltaike që janë në bashkëpronësi këtu do të vijojnë edhe këtë vit. Të nderuar qytetarë të Elbasanit, të nderuar kolegë të llogjikshëm, gjithçka thashë më lart tregon që ky është buxheti që furnizon, takimet e Selanikut, pazaret e Ohrit, e padyshim depozitat e Londrës. Paratë që shkojnë për këto depozita kthehen në Elbasan me leje ndërtimi shumë katëshe, parqe fotovoltaike. Njerëz të pashkolluar e të pa arsimuar që deri dje kan qenë thjesht çobenj lopësh dhe sot bëhen super miliarderët e Elbasanit. Politika është ajo që përbalt këdo që mendon ndryshe duke i çuar deri tek diskutimi i potureve. Ky është buxheti i atyreve që janë pa burra dhe që prej 2 javësh kam zbuluar se diskutojnë dhe për eliminim por nuk kuptojnë se bashkia nuk është as dyqan dyshekësh dhe as mobileri për të cilën vetëm kan dëgjuar se si i kan thënë punës mirmëngjes. Sot jua them me bindje të plotë, nuk ka rëndësi që kalon apo jo ky buxhet. Në sytë e mi sot brenda 15 janarit të gjithë Elbasanit por edhe gjithë Shqipërisë jeni lakuriq dhe ta gëzoni buxhetin.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo rastësisht pak më parë thashë që këto buxhete janë të balancuar në letër. E kam thënë dhe në vitin e kaluar dhe vitin paraardhës që financa është shumë argëtuese dhe që të balancosh këto shifra ti heqësh diku e ti vendosësh diku tjetër është gjëja më e thjeshtë që mund të bëhet. E rëndësishme është se një buxhet kujt i dedikohet, kujt i shërben dhe sa efektiv dhe efikas është. Në fakt nëse i referohemi të gjithë zërave të shpenzimeve për kolegët të cilët nuk e kanë përgatitjen ekonomike dhe financiare, i ftoj që të shikojnë në kolonat e zërave 600 dhe 601 që i përgjigjen pjesës së pagave dhe sigurimeve dhe do të shikojnë që rreth 70% e të gjitha shpenzimeve të buxhetit të bashkisë në çdo vit shkon për paga dhe sigurime. Ndërkohë që përse i përket pjesës së shpenzimeve operative dhe investimeve në çdo fushë të qytetit të Elbasanit, në secilin nga këto që ju i keni ndarë me atë emrin e madh që quhen programe, por ato programe nuk janë gjë tjetër veçse rrugë, furnizime me ujë, kanale kulluese, facilitete për arsimin, veçse facilitete për transportin. Kanë një shumë mizerabël që i dedikohet. Nuk është e vërtetë sepse duket dhe në letër që këtu po përkrahet sporti, janë vetëm 25 milion

lekë që I shkojnë falë kontratës dhe pas realizimit të objektivave të AF Elbasanit. Teatri Skampa I vetmi institucion kulturor që I ka ngel këtij qyteti. Po të vini re të gjitha shpenzimet që supozohen të bëhen për Skampën, na u tha kryetar do e fusnit në rikonstruksion total më duket? Po kur se nuk ishte? Teatri Skampa që do të hyjë në rikonstruksion total, po të vini re ka një investim prej 73 milion lekësh të vjetra të cilat lidhen thjesht me paisje skenike, sistem ngrohje. Pse I harxhoni këto lekë në këtë mënyrë ju kur do ta fusni në rikonstruksion total? Le të jetë bashkëfinancim, në momentin që Skampa hyn në rikonstruksion total, ju I bëni njëherë pastaj I prishni? Këto janë lekët e qytetarëve, mund të shkojnë diku tjetër. Nuk e kam printimin e ri, pres ta shikoj. Akoma më vjen keq sesi qofshin edhe thërime ato para, vazhdojnë shkojnë për dekore të ditës së verës, të vitit të ri, ndërkohë që ato dekore prej vitesh qëndrojnë ato që janë. Keni 75 milion lekë dekore, po dekoroni dhe Gjinarin këtë vit. Një problematikë tjetër që dje e gjej në email dhe që lidhet pikërisht me buxhetimin me pjesëmarrje dhe me mënyrën sesi ju nuk I dëgjini prioritetet e qytetarëve. Të gjithë këshilltarët duhet ta keni marrë këtë emailin, nuk e di se sa e keni lexuar. Është një peticion I firmosur nga përfaqësues të komunitetit Rom të lagjes Rrapishtë, të cilët nuk kanë rrugë, nuk kanë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm dhe nuk kanë ndriçim. Në të gjitha prioritetet dhe investimet që I dëgjova me shumë kujdes, të vitit 2026 nuk ka asgjë të përfshirë nga kjo. Dhe jo më pak sesa 1-2 muaj përpara ne vazhdojmë dhe programojmë dhe shfaqim në letër projekte madhështore sesi duhet të integrojmë këto komunitete. Por si mund të integrohen komunitetet atëherë kur ne nuk I ofrojmë kushte bazë jetese? Si mund të flasim ne për dixhitalizim kur sapo dalim nga dera e shtëpisë biem në gropë dhe sa dalim nga ajo grupa hyjmë në një gropë tjetër? Kryetar ke vënë investime përse I përket rrugëve të fshatrave si prioritet dhe nuk jam kundër kësaj. Por a e ke parë qytetin? A e di që akoma nuk na ke sjellë në këshill dhe nuk e ke ndarë se kush e ka përgjegjësinë për mbylljen e të gjitha rrugëve që hapën ujësjellës kanalizimet? Edhe sa vite do rrimë kështu ne? Në fakt një buxhet I planifikuar financiarisht nuk mund të konsiderohet I analizuar pa marrë për bazë edhe ato që kanë ndodhur në 2025. Nga të gjitha prokurimet që keni realizuar në 2025 më bën përshtypje fakti i parë që janë të gjitha me flamur të kuq, mungesë konkurrence, mungesë transparence, problematika me arritjen e fondit limit. Kur hap dokumentat e tenderit detajimet janë minimale, unë nuk e di kur shkoni sqaroni fituesit e tenderave pastaj se sa janë metrat katrorë që duhet të

shtrojnë, metrat katrorë që duhet të konstruktojnë, kostoja për metër katrorë, se bëni relacione me fjalë skandaloze. Ajo që më tepër më shqetëson dhe më përket si kompetencë e këtij viti lidhet pikërisht me shërbimin ndaj të tretëve që Bashkia Elbasan vazhdon jep nga 25 në 27-tën përsa I përket pastrimit dhe gjelbërimit. U miratua paketa fiskale me tarifa të rritura. Keni miratuar edhe rritje të personelit sepse e keni kthyer në agjensi pastrim gjelbërimit. Dhe akoma janë 314.597.000 lekë të cilat I referohen këtij shërbimi. Si mund të flasi Bashkia Elbasan për efikasitet kur ka gati mbi 1500 puntorë tashmë të cilët I bie që nuk bënë punën e vet. Pse duhet të ja referojmë të tretëve dhe tja transferojmë të tretëve neve pastrimin e shërbim gjelbërimit? Pse vazhdojnë blihen makineri? Keni blerë makina në 2025-ën që kapin vlerën e 550 milion lekëve. Makina me kosha, pa kosha, 3 ton, 5 ton, vinça gjoja që si kemi parë dhe nga ana tjetër makina elektrike, makina të përdorura, po na shpjegoni për çfarë ju duhen? Ju shkonin dhe transferoni shërbimet, blini asete, merrni puntorë shtesë në punë dhe transferoni shërbimet. Qofshin dhe 1 lek këto të shpenzuara janë buxhet I qytetarëve, që duhet të shkojnë në xhepin e qytetarëve. Përsa I përket kontratës së inceneratorit të mbetjeve, është tjetër plagë që vazhdoni nuk e zgjidhni dhe që trashëgohet shuma që duhet paguar nga viti në vit me të njëjtën kosto, ndërkohë që sot nuk ekziston më e as nuk ka ekzistuar përpara. Ndaj me keqardhje them që letrat flasin ndryshe por pamja e qytetit tonë, zbrazja e qytetit tonë, dhe unë e jetoj çdo ditë këtë vënd, është në nivele të mjerueshme. Faleminderit!

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë kisha një propozim që herët e tjera kryetarët e grupeve të flasin në fund, mbasi të kenë folur të tjerët sepse I bie si mbas dasmës bëjmë fejesën. Gjithmonë kryetarët e grupeve flasin pas të tjerëve dhe ti e di shumë mirë. Buxheti, me aq sa marr vesh unë nga shifrat ekonomike 79% është për rroga dhe shpenzime të administratës, dhe 21% është për investime që do të thotë në 100 lekë 21 janë për investime. Pjesa më e madhe shkon për paga, për shpenzime administrative, ka mungesë transparence dhe efikasiteti. Pjesa e investimeve apo rikonstruksioneve janë më shumë estetike dhe fasada pa ndërhyrje pra në një farë mënyre janë fasada por estetike për afatshkurtra. Projektet nuk adresojnë problemet që janë në bazë dhe prisja në fakt një buxhet të ishte më I mirë orientuar drejt shërbimeve bazë sepse nuk është produktiv, e thashë dhe njëherë është e gjitha një estetike. Unë do të bëja një 2-3 pyetje mbase dhe administratës apo kryetarit. Pashë tek zërat aty thoshte Rruga Gur

I Zi Labinot Katund po më tha zotëria që e kishit ndryshuar ishte Griqan Labinot Katund, kjo do të bëhet me asfalt apo vetëm rikonstruksione dhe do arnohet në një farë mënyre. Po Rruga e Varrezave në Labinot Katund? E re me asfalt. Po e Samurrit? Çdo vit kemi sjellë kërkesë për Rrugën e Varrezave Griqan Poshtë sepse është bërë një problematikë e madhe ajo. Nuk e di Rrugën Xibrakë-Qerret, sepse vit për vit e çoni tek fondi i zhvillimit dhe nuk miratohet. Mbase është bërë keq ky projekt ose e fundit fare le të shkojnë të gjithë deputetët majtas djathtas le të llobojnë atje, jo të shtyjnë njëri tjetrin prej xhaketash. Doja për ujësjellësin Xibrakë doja të kisha një ndërhyrje sepse I kam thënë dhe kryetarit nënjë bisedë dikur. Këto kisha gjërat më kryesore sepse I thanë të tjerët prandaj e kisha si ide që kryetarët e grupeve të flasin në fund sepse I bie të ripërsëriten në vazhdimësi. Faleminderit.

Eva Bica-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak, sot ndodhemi në mbledhjen më të rëndësishme të vitit, ku përmes diskutimit dhe miratimit të buxhetit përcaktojmë qartë rrugën në të cilën do të ecë Bashkia Elbasan gjatë vitit 2026. Në këtë buxhet do të ndalem në dy shtylla themelore të zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit tonë: arsimin dhe mbështetjen sociale. Arsimi mbetet një prioritet real i këtij buxheti. Përmes fondeve të parashikuara për arsimin parashkollor dhe parauniversitar garantohet jo vetëm funksionimi i institucioneve arsimore dhe mbulimi i personelit mësimor dhe stafit mbështetës, por edhe përmirësimi i drejtpërdrejtë i kushteve të mësimin. Fondi i përgjithshëm i parashikuar për arsimin shkon në rreth 880 milionë lekë, çka tregon qartë vëmendjen që i kushtohet këtij sektori jetik. Një element shumë i rëndësishëm i këtij buxheti janë investimet në shkolla. Vetëm për vitin 2026, këto investime kapin vlerën mbi 56 milionë lekë, dhe synojnë rikonstruktionin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, përmirësimin e kushteve fizike dhe të sigurisë, krijimin e ambienteve më dinjitoze dhe funksionale për nxënësit dhe mësuesit, si dhe përshtatjen e shkollave me standardet bashkëkohore të mësimdhënies. Konkretisht, shkollat “Naim Frashëri”, “Dhaskal Todri” dhe shkolla në Shushicë do të rikonstruktohen në bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit, duke sjellë përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën arsimore. Këto investime nuk janë thjesht ndërhyrje infrastrukturore, por janë investime në cilësinë e arsimit, në barazinë e mundësive dhe në të ardhmen e brezave të rinj, si në qytet ashtu edhe në njësitë administrative. Po aq i rëndësishëm është edhe zëri i mbështetjes sociale, i cili në këtë buxhet reflekton përgjegjësi dhe

ndjeshmëri sociale. Fondi i parashikuar për mbështetjen sociale është rreth 346 milionë lekë, dhe synon mbrojtjen e kategorive në nevojë, garantimin e shërbimeve sociale bazë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit për situata emergjente, duke siguruar që askush të mos mbetet pas. Fondet për rikonstruksionin e Qendrës Sociale Balashe, si dhe funksionimin e qendrave ditore për të moshuarit pranë vendbanimit të tyre, janë një shprehje e qartë e orientimit social të Bashkisë drejt shtresave në nevojë. Gjithashtu, mbështetja me qira për strehë emergjente për viktimat e dhunës në familje është një politikë që duhet mbështetur fort nga ana jonë, si një detyrim moral dhe institucional. Përfundimi i investimit në çerdhen nr. 5, si dhe hapja e një çerdheje në katin e parë të Qendrës Balashe, janë lajme shumë të mira për nënat e reja, duke krijuar mundësi reale për integrimin e tyre në tregun e punës dhe duke garantuar mundësi të barabarta si për familjet në qendër të qytetit, ashtu edhe për ato në zonat periferike. Ky buxhet tregon qartë se Bashkia Elbasan zgjedh të investojë te njerëzit, te fëmijët, te shkollat dhe te mbrojtja sociale. Ai ndjek një ekuilibër të drejtë mes zhvillimit dhe solidaritetit, mes nevojave të sotme dhe vizionit për të nesërmen. Për këto arsye, duke vlerësuar rëndësinë e investimeve në shkolla dhe mbështetjen sociale si themele të një shoqërie më të drejtë, më gjithëpërfshirëse e më të fortë, ju bëj thirrje që ta mbështesni dhe ta miratoni këtë buxhet si një buxhet në shërbim të komunitetit dhe të ardhmes së Bashkisë Elbasan. Faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ka një propozim për të hedhur në votim por unë propozoj pas fjalës së Znj.Valbona.

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Megjithëse bashkia ka një drejtori e cila cilësohet si audit I brendshëm dhe duke qenë se një pjesë e prokurimeve publike I kanë tejkaluar në mënyrë marramendëse afatet dhe fatkeqsisht kompanitë fituese janë gjithmënë ato kompani që I cilësojmë si familjare. Ato të cilat përfitojnë tenderat kryesore të bashkive. Unë po ju jap një shembull konkret sërish qendra multifunksionale dhe e këshillimit të karrierës e cila është prokuruar që në 2024, ish PS-ja. U vendos një tabelë në fund të 2024-ës para fushatë, Znj.Bylykbashi pati debat me mua dhe tha do fillojnë shumë shpejt punimet, e fitoi tenderin Ergi Shpk dhe afati I punimeve ishte 3 muaj por kaloi 2025 po vjen 2026 dhe në atë godinë është vënë vetëm gardhi rrethues. Kjo gjë ka

ndodhur edhe me një prokurim tjetër publik që është muzeu Aleksandër Xhuvani në kala. Unë po marr 2 shembuj konkret, e keni të aksesueshëm të gjithë dhe mund ta shihni lehtësisht. Si bëhet kur paratë shkojnë në këto destinacione dhe firmat nuk I prokurojnë në kohë e në afate e ti vëjnë këto në shërbim të qytetarëve. Tjetër, ja kemi kërkuar që në komision zonjave të financës që planifikimi I buxhetit sipas sektorëve arsim, kulturë, sport dhe të tjera të na vijë I dëtajuar. Ku konsiston, fjala bie kaldaja ishte një zë aty, ku do investohen këto kaldaja? Në ç'vend? Zoterinj edhe kur bëjmë një buxhet familjar të tjeshtë që harxhojmë ato shpenzimet tona mujore, ditore dhe themi kaq ky zë, kaq ai zë, jo më sikur të ishte një thes I madh. Se ku do investohen këto kaldaja? Së fundmi e di ku është problemi, ne shumë bukur një ditë mund të marrim edhe një nismë tjetër sepse pavarsisht se ju e shkritë komisionin e auditimit ne sërish me firmën e 15 antarëve të opozitës, meqë pozita është palë dhe I duket ky buxhet fushë me lule, ne mund ta ngremë këtë komision auditimi dhe do kërkojmë edhe ndihmën e organeve përkatëse për të na ndihmuar dhe për të na dhënë një krah në paqartësitë tona që kemi lidhje në mënyrën sesi shpenzohen paratë publike. Do doja sërish, jeni në kohë që planifikimin e buxhetit ta bëni sipas sektorëve dhe çdo sektor ashtu siç ju vjen nga drejtoritë përkatëse të na I paraqisni edhe ne sepse fundja këto duhet të jenë të matshme. Ne nuk masim dot ushqimin që ha fëmija në çerdhe, po sa banka, sa makina blehen, sa korrëse bari etj etj? Këto janë lehtësisht të verifikueshme, me fletë të bëheni ju këto gjëra nuk mbulohen dot. Ju faleminderit.

Rudina Mita-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

I nderuar kryetar I Bashkisë Elbasan, të nderuar Antarë të këshillit Bashkiak! Në kuadër të diskutimeve për hartimin dhe miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si Këshilltare Bashkiake por edhe nënkryetare e aleancës së grave këshilltare të Bashkisë Elbasan, në mbështetje të angazhimeve të bashkisë në fushën e mbrojtjes sociale dhe barazisë gjinore paraqes sot që të shqyrtojmë dhe të mbështesim një kërkesë të forumit të gruas Elbasan. Forumi I gruas Elbasan kërkon mbështetje financiare në shumën 100.000 lekë për periudhën janar-dhjetor 2026, në funksion të ofrimit të shërbimeve psiko-sociale ligjore dhe akomoduese për viktimat e dhunës në familjet në Bashkinë Elbasan, të pajisura me urdhër mbrojtje dhe urdhër të menjëhershëm mbrojtje nga gjykata. Duke vlerësuar pozitivisht mbështetjen e vazhdueshme të Bashkisë Elbasan për 3 vite rradhazi për mbulimin e qerasë së strehës së emergjencës nga ana e fondit të gruas Elbasan,

kërkohet gjithashtu rritja e pagesës mujore të qerasë nga 23.000 lekë në 28.000 lekë për vitin 2026 dhe kërkesë që vjen si pasojë e rritjes së përgjithshme të çmimeve të qerasë së banesave prej presionit të vazhdueshëm nga qeradhënësja për lirim të ambientit aktual, nevojës për të garantuar vazhdimësinë e një ambienti të sigurtë i cili ndodhet pranë drejtorisë vendore të policisë Elbasan dhe që ka rëndësi të veçantë për sigurinë e viktimave. Konsideroj se kjo mbështetje përbën një investim social të domosdoshëm në përputhje me detyrimet ligjore të bashkisë dhe politikat vendore për parandalimin e dhunës në familje dhe në mbrojtjen e viktimave. Në këtë propozoj që kjo kërkesë të përfshihet dhe të miratohet në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026. Kjo kërkesë e tyre është adresuar pikërisht kryesisë dhe sekretarisë së Aleancës së grave Këshilltare të Bashkisë Elbasan. Faleminderit.

Indrit Abdiaj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar kolegë, së pari doja të falenderoja të gjithë ata që përgatitën këtë buxhet. I cili dëshmon punën e mirë të Bashkisë Elbasan në tërësinë e saj. Buxheti i vitit 2026, në komponentin e tij për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përfaqëson një hap konkret në zbatimin e Strategjisë së Gjelbër të Bashkisë, e cila synon kalimin drejt një modeli zhvillimi më të qëndrueshëm, më efikas energjetikisht dhe më miqësor ndaj mjedisit. Në këtë kuadër, janë parashikuar 39,300,000 lekë për projekte që lidhen drejtpërdrejt me tranzicionin energjetik, përfshirë energjinë e rinovueshme, automjetet elektrike dhe sistemet fotovoltaike. Këto investime përputhen me objektivat kryesore të Strategjisë së Gjelbër: uljen e emetimeve, rritjen e eficiencës energjetike dhe përdorimin e burimeve të pastra. Një ndër shtyllat kryesore të kësaj strategjie është menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve, i materializuar përmes projektit trevjeçar për ndërtimin e Qendrës së Kompostimit, me një vlerë totale prej 35 milionë lekësh. Ky investim synon reduktimin e mbetjeve që përfundojnë në landfill, përmirësimin e ciklit të riciklimit dhe krijimin e një modeli më të avancuar të ekonomisë qarkulluese. Po ashtu, instalimi i sistemeve fotovoltaike në shkolla, me një fond prej 13 milionë lekësh, nuk është vetëm një investim energjetik, por edhe një masë edukative, që përçon te brezat e rinj parimet e Strategjisë së Gjelbër dhe kulturën e qëndrueshmërisë. Në të njëjtën linjë qëndron edhe investimi prej 5 milionë lekësh për automjete elektrike për shërbimet bashkiake, si pjesë e dekarbonizimit të flotës publike. Strategjia e Gjelbër reflektohet qartë edhe në fushën e mbrojtjes së pyjeve dhe biodiversitetit,

përmes projektit dyvjeçar për instalimin e kamerave për zbulimin e hershëm të zjarreve në pyje, me financim 16.3 milionë lekë në vitin 2026 dhe 16.7 milionë lekë në vitin 2027, si dhe përmes alokimit të 25,440,308 lekëve për investime në pyje, kullota dhe masa parandaluese ndaj zjarreve. Në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit praktik, Strategjia e Gjellbër gjen zbatim edhe përmes ndërtimit të serave hidroponike në shkolla, me një fond prej 13 milionë lekësh, duke nxitur bujqësinë urbane dhe ndërgjegjësimin mjedisor. Gjithashtu, projekti pilot prej 3 milionë lekësh për mbështetjen e artit dhe zejeve në shkolla kontribuon në ruajtjen e traditës dhe zhvillimin lokal të qëndrueshëm. Në përfundim, ky buxhet nuk është thjesht një listë shifrash, por një instrument konkret për zbatimin e Strategjisë së Gjellbër të Bashkisë, duke ndërtuar një qytet më rezilient, më të shëndetshëm dhe më të drejtë për brezat e sotëm dhe ata që vijnë pas nesh. Ndërkohë që kam vetëm diçka që e kisha dhe në përgjithësi për inspektoriatet dhe për policinë bashkiake sepse mbi ta besoj që qendron edhe barra më e madhe që të jenë më aktivë, më vigjilent dhe më të përgjegjshëm. Faleminderit.

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Dëgjova me vëmendje gjithcka që u diskutua me vjen keq për mbrojtjen që I beri shumica pork jo është politika juaj dhe sic I thonë që vesi del me shpirtin. Shumicën e buxhetit do e con për paga për shpenzime operative dhe për lluks. Atë që shikoj po e nis që nga fillimi ka një rritje prej 200 milion lekësh pork jo është e bazuar në rritjen e tarifave dhe të gjitha që u rriten në paketën fiskale një muaj më parë plus keni shtuar dhe dorën me gjat ndaj qytetarëve me 5 fish dhe e kundërshtoj zotin Indrit Abdiaj që I bën thirrje policisë Bashkiak nuk është e drejtë të gjobisë qytetarë e këtij qyteti për të mbushur arkën e bashkisë pa ju ofruar më parë atyre mundësinë që ato ti zbatojnë rregullat e qarkullimit dhe të parkimit sepse sic jut ë gjithë e dini të gjes parkim në Elbasan është kthyer në një mankth. Për sa I përket pse është rritur buxheti me 200 milion ku është shtuar dhe transferta e pakushtezuar dhe ajo specifike dhe në ato pak indikatorë ekonomik që unë shikoj ktu në të ardhurat që sjellin në bashki nga biznesi ka rënie jo rritje sepse me atë që jam informuar numri biznese është tkurrur ne 200 biznese dhe kjo tregon një renje të gjendjes ekonomike të qytetit të elbasanit dhe kjo tregon sic thanë dhe parafolësit që mbrojtën buxhetin që ky është një buxhet ambicioz që përmbush jo të gjitha sepse pranoni dhe ju që problematikat në qytet janë shumë herë më të mëdha sec mund të zgjidhi ky buxhet por koha është vertetuar si më I miri I

gjithckaje që ne mund të flasim ktu në të njëjtën mënyrë u mbrojt dhe buxheti I vitit të kaluar nëpër letra dhe diskutime dhe debate me njëri tjetrin dikush e mbrojti dhe dikush e atakoi por pas një viti jeta e qytetarëve është po ajo rrugët janë po ato problemet janë po ato varfëria është po ajo një e re që është ulëritëse është mbyllja e 200 bizneseve se unë aty e kam se aty marr vesh të tjerat ja le kolegëve që I shteruan si zonja Doris dhe shumë të tjerë që kanë mbaruar për ekonomist dhe I kapin me Shifra dhe me fakte problematikat e buxhetit. Për sa I përket pikës tjetër tek kapitulli numer 5 ju e keni tkurrur zërin e investimeve me 3% dhe I transferuar 2 % tek shpenzimet e personelit dhe 1 % tek shpenzimet operative cka vërteton që trendi juaj është më shumë para për paga shpenzime dhe lluks sesa për investime afatshkurtër dhe afatgjatë që rikthjenë ekonominë në punë nëse elbasani nuk performon si ekonomi kto probleme do të kemi me shifrat. Për sa I përket arsimit zonjë ke rënë ke 5% më pak të ardhura, arsimi është ulëritës dhe tek arsimi dua tju them dicka sepse mora informacin tek mbledhja e komisioneve për kërkesat që ju vin se ne ju kërkojm buxhet dhe kto para të sektorit të arsimit në bazë të kërkesave të tyre ju bëj thirrje që mos I miratoni kërkesat thjesht për kancelari por ti pajisni shkollat me mjetet e nevojshme që nxënësit të zhvillojnë një orë mësimore të denjë që të rrisim breva që do ta cojnë përpara këtë qytet sepse me kete infrastrukturë ne po I hyjmë ne hak fëmijëve tanë hapsira publike nuk ka mjetet nuk janë të mjaftueshme nëpër shkolla mjafton fakti që tek shkolla ku unë coj fëmijët e mi atje ora e edukimit fizik bëhet në ambjent të hapur nuk kanë një palestër ku sot të gjithë ato që marrin vesh nga shëndet insistojnë që të kemi një përgatitje fizike dhe një investim më të madh në fizikun dhe në shëndetin e njerëvze sepse njerëz me shëndet të mirë dhe fizikisht janë më të denjë për shoqërinë. Kështu dhe një pikë tjetër ktu ajo që pashë në zëra në njësitë shpenzuese është që akoma në menaxhimin e mbetjeve buxheti I bashkisë së Elbasanit shpenzon 3.3 milion euro dhe ktu ka dhe një paradoks tjetër që vetëm 9% shkon për paga dhe 91% shkon për shpenzime ata që menaxhojnë mbetjet kanë blerë makineri që duhet shumë pak forcë puntore dhe e realizojnë përmes teknologjisë së lartë që unë nuk I shikoj as tek fusha e mbetjeve as tek mjete që përdoren. Gjithashtu di dhe nëpërmjet miqëve që unë kam që dhe punonjësit që punojnë janë të nënpaguar dhe të nënvlerësuar kshuqë ktu inceneratori akoma na merr 3.3 milion euro dhe kto nuk kanë pse të shpezohen për këtë lloj shërbimi që na rikthehet mbrapsht une jam dakord që mbetjet do hiqen por me një kosto më minimale. Për sa I përket zërit të investimeve nga të gjithë

investimet une shikoj vetëm rikonstruksione, blerje makinash, blerje kompjuterash, blerje kondicionerësh unë nuk shikoj në këtë zë të investimeve që neve ta mendojmë që të kemi një unazë të Elbasanit vetëm unaza jugore e Elbasani tashmë është ezauruar me trafiku. Zoti kryetar fillon me hapa të vegjël pastaj ddalim tek të mëdhenjtë në fillim ti alokon fondet për një studim sepse ty kryeministri para disa kohësh të urdhëroi që të rishje të gjitha hapsirat publike dhe ju shmë mirë e dini ku është unaza veriore që është e zënë nga lokale nga biznese dhe është ngushtuar aq shumë sa që as për një makinë nuk mjafton në as ajo thjesht do të zgjeroheshe ose të hapet tek zona e institutit do të clironte goxha trafik. Ju mund ta neglizhoni por kjo ka të bëjë drejt për drejt me shëndetin publik sepse ndotja zhurma dhe shëndeti në Elbasan vetëm po shtohet dhe shoh shumë pak investime për hapsirat e gjelbra dhe pse ne e rritëm tarifën e gjelbërimit hapsirat publike në Elbasan mungojnë Elbasani është kthyer në një fshat të madh nga mënyra e jetesës cdo lagje duhet të ketë zonën e saj rekreative dhe shlodhëse për fëmijët tane ju këtë as nuk e keni fare në axhendë jemi akoma tek rikonstruksioni I rrugëve që kanë 50 vjet që janë bërë thjesht I rikualifikojmë kaq, rrugë të reja unë nuk shikoj prandaj në zërin e investimeve unë propozoj që jua fusni në këtë buxhet të paktën një firmë që të na bëjë një studim për unazën e Elbasanit që të clirohet trafiku mos presim Bypasin, jepini zgjidhje hapsirave publike, hapsirave të gjelbra dhe stimulimin e bizneseve të reja sepse vetëm kshu do të bëhemi një qytet Avangard në shqipëri Faleminderit.

Ilirjan Sadiku- Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar koleg herës tjetër do ti kërkoj atij stafi të mrekullueshëm atje që të na bëjë secilit nga ne një buxhet dhe secili të shprehë dëshirat e veta. Problemi është që ne duhet, dua të falenderoj të gjithë stafin që na mundësojë në këtë debat konstruktiv. Ti sa herë ta hapësh këtë buxhet aq herë do gjeësh defekte buxhetet nuk janë perfekte. Të nderuar këshilltarë ky nuk është buxheti më i mirë por për sa mëndat kam unë këshilltarë buxhet më të mirë se ky nuk kam pas unë ju ftoj ta votoni

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ne cdo vit bëjmë një buxhet realist dhe të orjentuar drejt qytetarëve ku në thelb janë investimet janë shërbimet, mirëmbajtjet dhe përqëndrimi kryesor I joni vazhdon të jetë përmisimi I jetës së qytetarëve. Këtë vit përfundojmë një nga projektet më të mëdha për të rinjtë dhe për fëmijët që është këndi sportive Dua të

Luaj prej 22 mij e 30 metrash katror të cilat do të shërbejnë për të rinjtë për sportin për të moshuarit dhe për të gjithë qytetarët e Elbasanit është një investim I cili shtrihet anësh ish rrugës së vjetër të varrezave 22 mij metra katror I cili përfundon shumë shpejt kemi projektin e kalasë së Elbasanit ku dhe aty përfundon projektimi dhe do të jetë nje nga projektet kryesore inovative të rikonstruksinit të kalasë dhe do të jetë projekti kryesor zhvëllimor I qytetit të Elbasanit.vazhdojmë me projektin që kemi për automotoparku po përfundojmë nyjet lidhëse të infrastrukturës po bëjmë nyjet e tjera lidhëse për ta lidhur me lagjen Emin Matraxhiu.Do të vazhdojmë me projekte,do të kemi një focus kryesor tek turizmi gjinarin.rruga e re e funarit një nga investimet kryesore ku do te bëhet dhe zip line.Ky buxhet është një buxhet realist I fokusuar tek qytetari tek shërbimet kemi 19 rrugë të reja rurale ose 3 milion euro vetëm për rrugët rurale për të përmisuar cilësin e jetesës së fshatrave.Kemi një investim prej 1. 5 milion eurosh vetëm në sheshet e pallateve për të vazhduar me projektet e tjera dhe qëllimi jonë kryesor ka qënë që të kemi një balance ndërmjet investimeve ne fshat dhe në qytet.Sherbimi do të ketë një buxhet ndaj qytetarëve,bashkia Elbasanit një pjesë e shërbimeve po e bën vet sic është mirëmbajtja dhe pastrimi I fshatit.Ky është një buxhet real mbi të ardhurat faktike.Do ju ftoja tyë gjithë ta votini buxhetin pasi është një buxhet real në shërbim të qytetarëve.faleminderit

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkika Elbasan

Unë isha përgatit dhe për të mbajtur një qëndrim timin për buxhetin por pjesa më e madhe u ezaurua vendosa të mos e mbaj atë fqëndrim që kisha më ngacmoi kryetari me fillimin e mbylljes së tij e cila filloi pak me ironi duke cilësuar që I ka dëgjuar disa vite rresht mendimin e këshilltarëve për buxhetin dhe vazhdon dhe I ridëgjon nuk kemi faj ne kryetar që ndoshta dhe riciklojmë vendimet dhe mendimet tona për buxhetin pasi dhe ne kemi shumë vite rresht që dëgjojmë për turizmin për funarin për automotoparkun dhe nuk shohim gjë hoteleria është parashiku vetëm 10 milion lekë ndërsa gjobat I ke 620 milion lekë ky është qyteti ky është turizmi ky është automotoparku që kemi kaq vite që e dëgjojmë kshuqë nuk është ndonjë cudi.Mu bë qefi për cështjen e 22 m katror për rininë por në komisione kishe parashiku 0 lekë për rininë turp I madh në komisione kam ngritur zërin unë për këtë cështje 0 lekë për rininë është rishikuar dhe është vënë një 5 milion lek unë e kam ktu buxhetin e vjetër më behet qefi për ato 22 mij metra

katrot dhe të uroj me gjith shpirt që ti bësh por jo ironi me qëndrimet e këshilltarëve.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 9 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (Y.Balliu; V.Balliu; E.Jaurri; M.Kaculi;)

(B.Çopja; A.Kana; A.Meçja; Z.Muzhaqi; A.Shtylla)

V.A.(R.Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6. Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe njësive operative vartëse të saj, si dhe saktësimin e emërtesave të njësive operative në tabelat e pagave, nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të nënpunësve civilë e të punonjësve të bashkisë dhe njësive operative vartëse të saj për vitin 2026.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 6 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (Y. Balliu, B. Copja, M. Kaculi, A. Kana, A. Mecja, Z. Muzhaqi)

V.A (V. Balliu)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7. Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për tu përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 0 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(V.Balliu)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026

Altin Mecja- Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Doja të pyesja sa është numri total I aplikantëve ,a është pasqyruar lista dhe sa nxënës kanë pasur mundësi ankimimi

Evis Stafa-Përfaqësuese e Administratës

Ktë vit kemi pasur rreth 1328 nxënës aplikues ,517 nga arsimi profesional 751 nga arsimi bazë,55 nxënës nga shkolla Zëra jete dhe 5 nxënës me banim Elbasan por që ndjekin studimet në bashkitë e tjera.a ka pasur më shumë ankimime atëhere lista e nxënësve përfitues do të publikohet mbasi kalon në këshill bashkiak dhe dua të theksoj që nga muaji shtator dhe deri në muajin dhjetor ne kemi qënë në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë nxënësit ,mësues dhe drejtues për ti sqaruar rreth cdo paqartësie që ato kishin lidhur me dokumentacioni që ato do të plotësonin dhe të gjithë dhe kriteret që do të përmbushin për të fituar.Cdo të enjte kemi qënë në kontakt.Nga shkolla profesionale kemi 458 nxënës që plotësojnë kriteret ,115 aplikojn për herë të parë dhe jemi brënda kuotave,nga arsimi bazë kemi 504 që plotësojnë kriteret por sic është thënë dhe në relacion numri I kuotave që vjen nga ministria e arsimit është 200 ne kemi propozuar që të kemi fitues me gjysëm burse 400 nxënës dhe si rezultat kemi 385 nxënës që përfitojnë bursë dhe plotësojnë kriteret

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, miraton sa më sipër.


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9. Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit me emërtim Ish-Godina e Partive Politike (kati I tretë), Z.K 8524, Organizatës së Veteranëve dhe pasardhërve të Lanc Nga Bashkia Elbasan

Gledian Llatja-Kryetar i Bashkisë Elbasan

Ashu sic e dini kemi një godinë që quhet Godina e selive të partisë të cilën një pjesë e ka bashkia Elbasanit, një sipërfaqe jo të gjithë një nga kto ambjente në katin e tretë sipas kërkesave është kërkuar nga shoqata e veteranëve e cila merr përsipër vet rikonstruksionin e këtyre ambjenteve që do të mbetet pronë e Bashkisë së Elbasanit. Është një kërkesë e tyre nësi administrat mund ta mbështesim

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 6 kundër, 3 abstenim, **nuk miraton sa më sipër.**

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me nr 6710 prot datë 02/12/2025 ndërmjet Bashkisë Krushevë (lider) dhe partner: Bashkinë Elbasan, Tjetër Vizion dhe Alka, Programi Shqipërisë, Instrumenti I asistencës së Para-Anderimit (IPA II)

Këshilli Bashkiak me 32 vota pro, 0 kundër, 3 abstenim, **miraton sa më sipër.**

V.A. (B. Copja, M. Kaculi, D. Madhi)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 11 e rendit të ditës

11.Mbi rinovimin e kontatave një -vjecare të shtetasve të më poshtëm(Banesat Sociale)

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 0 kundër, 3 abstenim, **miraton sa më sipër.**

V.A.(A.Kana, M.Kaculi, D.Madhi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 12 e rendit të ditës

12. Për miratimin e pranimin të një automjeti në formën e dhuratës

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 0 kundër, 1 abstenim, **miraton sa më sipër.**

V.A. (M. Kaculi)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 13 e rendit të ditës

13. Për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”, në Lagjen “28 Nëntori”, nga Bashkia Elbasan

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 0 kundër, 2 abstenim, **miraton sa më sipër.**

V.A. (B. Copja, D. Madhi)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, ora 13:24 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Zv. Kryetar Z. Zamir Muzhaqi, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 14 dhe 15 e rendit të ditës

14. Prezantim dhe diskutim mbi Raportin Vendor të Performacës 2024

15. Informacion mbi vlerësimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa aktiveve në ASHPR për vitin 2025

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

